



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 35/18
Prishtinë, më 14.11.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hot dhe Blerim Kuçi.

Munguan: Dardan Molliqaj dhe Fikrim Damka.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.10.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektkodit Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe amendamenteve të komisionit për Administratë Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozoi që rendi i ditë të plotësohet me dy pika të reja: shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër

Korrupsionit dhe shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës me plotësimin e dy pikave të reja, të renditura si pika 7 dhe 8, me tekstin si vijon: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.10.2018

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.10.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-054 për Gjykatat dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Për këtë pikë e kemi pasur në mbledhjen paraprake, dhe pas identifikimit të kotos shtesë buxhetore të amendamenteve të komisionit funksional, kemi kërkuar një vlerësim me shkrim nga Ministrisë së Financave për koston shtesë buxhetore. Fatkeqësisht, përkundër njoftimit, Komisioni për Legjislacion nuk na ka pritur në vlerësimin financiar dhe e ka dërguar projektligjin në seancë për shqyrtim të dytë. Projektligji për Gjykatat nuk përmban kosto shtesë buxhetore por amendamentet e Komisionit dhe propozuesve tjerë, si amendamenti 8, 11, 19, 21, 36, 42 dhe 48 sipas llogaritjes së Ministrisë së Financave përmbajnë kosto buxhetore prej 3.2 milion eurove. Këto mjete nuk janë në buxhetin e vitit 2018 por nuk janë as në buxhetin e vitit 2019 dhe vlerësimet 2020-2021.

Unë propozoj që ne ta trajtojmë këtë çështje dhe ti dërgojmë rekomandimet tek Komisioni për Legjislacion, dhe më pas ata në qoftë se dëshirojnë të mblidhen edhe një herë dhe ta plotësojnë raportin e tyre. Propozimi im është që rekomadimi i komisionit të jetë: Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Amendamentet e 8, 11, 19, 21, 36, 42.B dhe 48 përmbajnë implikime buxhetore shtesë në shumë prej 3,184,742 euro për vitet 2019-2021. Si dhe një pikë të tretë, ti rekomandojmë Komisionit për Legjislacion që të propozojë një amendament për Buxhetin e vitit 2019 lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Ligjit për Gjykatat, në mënyrë që këtë amendament të përfshijmë në trajtimin e komisionit tonë gjatë trajtimit të buxhetit.

Blerim Kuçi: Nuk kemi nevojë me propozuar tash amendamentin, por amendamenti mund të propozohet gjatë procesit në mes dy leximeve.

Kryetari: Komisioni të propozojë amendament në bazë të ndryshimeve që i ka bërë dhe në këtë mënyrë ta adaptojë këtë kërkesë.

Safete Hadërgjonaj: Në radhë të parë ndoshta është më mirë me analizue arsyeshmërinë e amendamenteve që përmbajnë kosto shtesë. Të analizojmë se a është një amendament i tillë apo nuk është i arsyeshëm? Në rast se ne e vlerësojmë si të arsyeshëm amendamentin e tillë atëherë ne mund të propozojmë koston buxhetore apo nëse nuk është i arsyeshëm, të rekomandojmë që të fshihet.

Kryetari: Në pjesën e arsyeshmërisë së amendamentit nuk e kemi në kompetencë të komisionit, por besoj se komisioni për legjislacion e kanë trajtuar këtë çështje dhe e kanë parë të arsyeshme të bëjnë një ndryshim të tillë.

Safete Hadërgjonaj: Megjithatë, me qenë se amendamentet kanë kosto buxhetore është temë e trajtimit në komisionin tonë, dhe nëse e shohim se është një kosto buxhetore, atëherë duhet të dimë se çfarë është ajo.

Kryetari: Komisioni funksional është kompetent që të propozojë amendamentet në bazë të fushës së tyre profesionale. Pra, Komisioni për Legjislacion me anëtarët e të gjitha partive politike na kanë dërguar amendamentet të cilat ata i kanë vlerësuar se sa janë të nevojshëm. Puna jonë është të tregojmë sa është kostoja e këtyre amendamenteve dhe të përcjellim rekomandimi në seancë dhe më pas deputetët e vlerësojnë, a ja vlenë për këto fonde shtesë, të krijohen këto ndryshime në legjislacion.

Prandaj, propozojë që të rekomandojë që projektligji për gjykata nuk përmban Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Amendamentet e 8, 11, 19, 21, 36, 42.B dhe 48 përmbajnë implikime buxhetore shtesë në shumë prej 3,184,742 euro për vitet 2019-2021. Si dhe një pikë të tretë, ti rekomandojmë Komisionit për Legjislacion që të propozojë një amendament për Buxhetin e vitit 2019 lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Ligjit për Gjykatat,

Safete Hadërgjonaj: Unë propozojë që në rekomandimin e komisionit të cekem cilat amandamente përmbajnë implikime shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 7 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

1. Projektligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nga deputetët Korab Sejdiu, Hajdar Beqa Albulena Haxhiu, Fitore Pacolli, dhe amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, për Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 8 të propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu, amendamentit 11 (Propozimi A i Komisioni Funksiona, që i referohet riformulimit të nenit 13, paragrafit 1.1.), amendamentit 19, amendamentit 21, amendamentit 36 (që i referohet nenit të ri me titull “Kushtet e veçanta për gjyqëtar”, paragrafi 1.5), amendamenti 42 (Propozimi B i deputetes Fitore Pacolli) dhe amendamenti 48, për të cilat amandamente të propozuara, kostoja shtesë buxhetore e vlerësuar është prej 3,184,742 euro dhe numri shtesë i punëtorëve prej 35 pozitive. Këto mjete buxhetore dhe pozita shtesë, nuk janë pjesë në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe në planifikimet buxhetore për vitet 2019-2021.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të propozojë amendament në Projektligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, për ndarjen e mjeteve buxhetore dhe numrin e shtesë të punëtorëve për vitin 2019-2021, për zbatimin e Ligjit për Gjykata, pas miratimit të tij.

4. Shqyrtimi i Projektkodit Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektkodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nga deputetja Albulena Haxhiu, nga Grupi Parlamentar Lista Serbe dhe nga Grupi i Grave Deputete, për Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media**

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Arbërie Nagavci: theksoi se për Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës, kemi disa vërejtje të cilat i kemi paraqitur edhe në komision sa i përket pëmbajtjes, kështu që do të abstenojë në këtë pikë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës dhe amendamenteve të komisionit për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Të ndryshme

9.1. Kryetari: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i ka dërguar një kërkesë urgjente Komisionit, ku thotë kështu: Shuma e planifikuar prej 1.9 milion eurove për ndërtimin e 192 shtëpive të komuniteteve e nuk është shpërndarë në vitin 2018 dhe janë vetëm 500,000 euro, dhe Ministria kërkon garancë nga komisioni që për vitin 2019, se do të ndahet pjesa e shumës së nevojshme për realizimin e projektit. Logjika ime është se një garancë të tillë nuk mundemi ta japim sepse garanca jepet me votim. Pra, fjala e komisionit në këtë fazë nuk vlenë edhe po të themi po kemi pasur mjete nuk e dimë a do të ketë derisa të kalojë ligji në seancë. Por çka mundemi është që ti i kthejmë përgjigje Ministrit dhe ti themi që do ta trajtojmë gjatë shqyrtimit të buxhetit.

Enver Hoti: Unë mendoj dhe propozoj që komisioni është mirë ta shqyrtojë dhe ta shtyjë përpara, pastaj mbetet vendimi i seancës për një gjë të tillë. Unë mendoj që ky projekt i cili është paraparë të realizohet në vitin 2018 dhe që ka të zotuar 1.9 milion euro rrezikohet projekti dhe nuk ka asnjë arsye të mos përkrahet, pasi që kërkesa ka qenë në kordinim me Ministrin e Financave dhe mendojë që ne mundemi ta realizojmë këtë. Nuk ka asnjë pengesë që nuk do të kalojë apo nuk do të bëhet pjesë e projekt buxhetit për vitin 2019.

Safete Hadërgjonaj: Unë zoti Enver nuk jam e priur të votoj diçka që del jashtë kornizës legjislative dhe Rregullores së Punës. Mua më vjen shumë keq ministrinë nuk kanë mundur të mirren vesh dhe ti rregullojnë këto çështje në qeveri, pa na i sjellur këtë problem në komision. E shohë të paarsyeshme sot të na adresohet përpara një shkresë e tillë për diskutim sepse nuk është punë e jona tash që ta diskutojmë këtë çështje. Kur të dalë buxheti në Kuvend për shqyrtim, secili deputet mundet të japë mendimin e vet në lidhje me pozicionet e ndryshme buxhetore. Ne si komision funksional, duhet të bëjmë punën më të mirë të mundshme në mënyrë që ta rregullojmë buxhetin, por edhe të mos e vendosim jashtë kornizave në tërësi buxhetin, i cili na ka ardhur në Kuvend.

Kryetari: Ligjërish nuk kemi hapësirë në këtë kohë për të vepruar ose për të marrur një vendim për ndonjë garancë, sepse më duket absurde që ne ta votojmë çfarë ndodhë në vitin 2019, kështu që kur të shqyrtojmë buxhetin, e shqyrtojmë edhe këtë kërkesë. Prandaj, përgjigje në kërkesën e ministrit është se kërkesa do të shqyrtohet gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të buxhetit.

9.2. Kryetari: Çështja e dytë që propozojë të diskutojmë është mundësia e anagazhimit të një eksperti afatshkurtër, që do të paguhet nga buxheti i komisionit, i cili do ti ndihmojë komisionit dhe stafit mbështetës në analizimin e Projektbuxhetit dhe kërkesave buxhetore për vitin 2019. Ju e dini se buxhetin e vitit 2018 me propozimin e komisionit është vendosur që të punësohen edhe dy zyrtar në njësinë mbështetëse dhe ata zyrtar ende nuk janë rekrutuar. Prandaj, propozimi është që si ekspert të anagazhohet Teki Shala, i cili ka punuar edhe më herët për komisionin në fazën e buxhetit, për të cilin të paktën për punën e tij janë në dijeni Safetja dhe Naseri.

Safete Hadërgjonaj: Theksoi se Teki Shala ka qenë një ekspert i angazhuar nga GIZ për një kohë bukur të gjatë na ka ndihmuar në buxhet. Pas përfundimit të kontratës me GIZ, ne e kemi angazhuar edhe përmes buxhetit të komisionit. Unë për vete nuk jam kundër për tu angazhuar sepse ka përvojën e buxhetit dhe ai nuk mundet të vendosë për asgjë në lidhje me buxhetin. Ai ka për të na bërë një analizë të projeksioneve buxhetore dhe çka është me rëndësi na ndihmon në fund dhe i ndihmon stafit në

përgatitjen e amendamenteve dhe ua lehtëson punën këtyre. Unë e vlerësoj shumë punën e stafit që e kanë bërë vazhdimisht, por i kemi edhe tri projektligje si komision funksional, prandaj eksperti do të mund ti ndihmojë stafit edhe në këtë proces.

Kryetari: Theksoi se edhe GIZ gjithashtu është duke bërë analizë për buxhet, kam kërkuar që jetë e gatshme para datës 21 në mënyrë që t'ua sjellë juve deputetëve/anëtarëve të komisionit.

Mërgim Lushtaku: Realisht ne e kemi pasur një vizitë shumë të mirë ne Austri dhe i kemi parë praktikën e mira të komisionit për buxhet dhe financa dhe kemi diskutuar se si të marrin përvojën e këtyre në këtë komision në parlament. Nuk e di a kemi mundësi kohore që të kemi koncentrimin me publikun dhe me pjesën universitare. Ndoshta është çështje shumë e ndjeshme, por besoj që realisht na nevojitet një konsultim në këtë drejtim që të kemi një analizë më të mirë dhe një planifikim sa më të mirë.

Kryetari: Në fakt unë kam kërkuar nga GIZ të na ndihmojë në ndërtimin e Njesisë për analiza buxhetore brenda Kuvendit dhe ata e kanë pjesë të planit të vetë modelin e Austrisë dhe kanë mbetur të bisedojë me Kryetarin e Kuvendit për të bërë njësinë mbështetëse për Komision për buxhet dhe financa.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht vendosi që të angazhojë z. Teki Shala, ekspertë i jashtëm për analizën e Projektbuxhetit për ndarjet buxhetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, dhe i njëjti do të paguhet nga buxheti i Komisionit për 23 ditë pune, në pajtim me Udhëzimin për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:40.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku